



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

PROJEKTI

ALBANOLOGJIA DHE REALITETET E REJA NË METODOLOGJI DHE BURIME



Elbasan, 2021

Tabela e përmbajtjes

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PROJEKTIT	3
KONTEKSTI	4
PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT	5
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT TË LARTË KU DO TË ZBATOHET	
PROJEKTI	6
PËRSHKRIMI I BASHKIMIT TË NJËSIVE KU DO TË ZBATOHET	
PROJEKTI	7
PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROJEKTIT	9
METODOLOGJIA E PROJEKTIT	12
ORGANIZIMI I STUDIMEVE DOKTORALE	13
PLANIFIKIMI I ECURISË SË STUDIMIT TË DOKTORATËS	14
ANALIZA SWOT	15
ANALIZA E TREGUT TË PUNËS	18
GRUPI I PUNËS PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT	20
FINANCIMI I PROJEKTIT	20



PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PROJEKTIT

Fusha kryesore e kërkimit:	Albanologji
Emërtimi i programit	Doktoratë në albanologji
të studimeve të doktoratës:	
Cikli i studimeve:	Cikli i tretë
Lloji i programit:	Doktoratë
Njësia bazë:	Departamenti i Gjuhësisë Departamenti i Histori– Gjeografisë Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike (QSAB) Fakulteti Shkencave Humane
Njësia kryesore:	
Studimi me kohë normale,	
shprehur në vite:	3
Studimi me kohë të zgjatur,	
shprehur në vite:	5
Gjuha e studimit:	Shqip
Të dhënat për	
Koordinatorin	Pozicioni në IAL: Zv/Dekan i
e Doktoratës:	Fakultetit të Shkencave Humane



KONTEKSTI

Një ndër objektivat më të rëndësishme që kërkohet të arrihet sot nga Institucionet e Arsimit të Lartë në vend, është nxitja dhe evidentimi i kërkimit shkencor, mbështetur dhe në premisat që synon të krijojë politika e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin. Në lidhje me kërkimin shkencor në universitete, synohet nxitja dhe mbështetja në ndërmarrjen e nismave afatgjata dhe me baza të shëndosha në drejtim të kërkimit shkencor, në përputhje me nivelet e institucioneve homologe në vendet evropiane, duke u shndërruar në faktor nxitës dhe mbështetës në këtë drejtim, si dhe në hapjen e perspektivave rjonale e më gjerë për bashkëpunim mes palëve.

Studimet në fushë të albanologjisë po pësojnë reformime cilësore në dy drejtime: në metodologji, për shkak të përqafimit të metodologjive të reja nga shkencat shoqërore (metoda sasiore dhe cilësore), përdorimit të teknologjisë në këto studime, si edhe në burimet dokumentare, falë mundësive të reja që janë krijuar nga shkëmbimi kulturor- shkencor dhe qasjeve të reja në arkiva dhe biblioteka të shteteve fqinje në Ballkan, në Turqi dhe në Evropë.

Me ndryshimin e Ligjit të Arsimit të Lartë (Nr. 80/2015), cikli i tretë i studimeve doktorale u rikonceptua duke pësuar ndryshime të qenësishme, të cilat sollën nevojën për riorganizim të programit kërkimor-shkencor doktoral që ofron Fakulteti i Shkencave Humane. Gjatë kësaj periudhe, ndërprerja e regjistrimeve të reja, ndryshimi i realiteteve shoqërore dhe ekonomike, reforma universitare që vjen e thellohet, duke bërë që të ndihen pasojat edhe në universitetin tonë, si edhe përvoja e grumbulluar me doktoratat e viteve akademike 2011-2012 dhe 2012-2013, bën që ky riorganizim të kryhet mbi një perspektivë më të qartë dhe përvojë të konsoliduar. Gjatë kësaj periudhe, cikli i tretë i studimeve nuk ka qenë i hapur në universitetet tona dhe, për këtë arsy, interesit për të ka qenë i shtuar ndër vite dhe numri i atyre që presin për t'u regjistruar në këtë program është i konsiderueshëm. Të interesuarit kanë qenë jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe në trojet shqiptare jashtë kufijve shtetërorë.

Tashmë, ne kemi një përvojë të mirë me doktorimin edhe të 3 studentëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut, me rezultate shumë të mira.

Me këtë riorganizim, ne synojmë t'u ofrojmë studentëve një program cilësor, për shkak se kërkimet albanologjike në Shqipëri përbëjnë traditën më të rëndësishme të kulturës dhe shkencës shqiptare. Po ashtu, edhe Universiteti i Elbasanit dhe qyteti përbëjnë një trashëgimi të rëndësishme që janë një garanci për cilësi, konkurrencë, identitet, njohuri të përditësuara, përmirësim të aftësive kërkimore-shkencore. Kështu që, përvèç traditës së pasur të studimeve albanologjike, lind nevoja e përditësimit të njohurive shkencore dhe të studimeve të reja në fushë të albanologjisë, sipas këndvështrimeve të reja që ofron shkenca botërore sot. Kjo ofertë akademike cilësore do të vijë si rrjedhojë e bashkëpunimit me institucione të tjera kërkimore-shkencore, arkivore dhe të kulturës në qytet dhe më gjerë.



PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Projekti “Albanologjia dhe realitetet e reja në metodologji dhe burime” ka si mision të përgatisë studiuesit të përparojnë në çështjet e studimit shkencor, të krijojë një gjeneratë studiuesish të aftë dhe me nivele të larta akademike, sikurse dhe homologët e tyre në Rajon dhe Evropë, me qëllim zhvillimin sa më të plotë të aftësive për progres, duke kontribuar në hulumtime dhe trajnime në fushën e gjërë të albanologjisë.

Në bazë të këtij projekti qëndron rëndësia në hulumtimin dhe zhvillimin e trashëgimisë albanologjike të vendit dhe rajonit, si dhe në rritjen e cilësisë së arsimit universitar, përmes studimit të dukurive dhe kontributeve në albanologji.

Ky projekt, përmes zbatimit, synon jo vetëm nxitjen e kandidatëve në kërkimin shkencor, por njëkohësisht mundësitë që ofron ky projekt, synojnë koordinimin e mirë të punës në kuadër të politikave të ndërmarrë në vend në kuadrin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe rritjen e bashkëpunimit të Universitetit të Elbasanit me institucionet tjetra kërkimore në Rajon e Evropë, por gjithmonë duke e vënë theksin në fuqizimin e frysës kombëtare në kërkimin shkencor.

Projekti “Albanologjia dhe realitetet e reja në metodologji dhe burime” ofron mundësi që stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Humane në nivel profesorati të përfshihet në veprimtari kërkimore, të nxitet për studime të thelluara në fushën përkatëse kërkimore-shkencore, duke mbështetur kështu studentët ekselentë, të cilët synojnë karrierën profesionale akademike. Departamentet dhe fakulteti nisen nga parimi se nuk mund të ketë mësimdhënie cilësore në universitet pa kërkim shkencor cilësor, kështu që mbështetja për këtë projekt është një standard i rëndësishëm i cilësisë institucionale.

Në mënyrë të veçantë lind nevoja të pasurohen studimet albanologjike mbi bazën e fakteve dhe të informacionit të ri shkencor, të zgjerohet rrethi i problematikës shkencore dhe gjeografja e këtyre studimeve duke përfshirë si pjesë të tyre aspekte të jetës gjuhësore, historike e kulturore të shqiptarëve brenda dhe jashtë kufijve politikë të shtetit të sotëm shqiptar, si edhe të diasporës shqiptare.

Ky projekt synon të trajtojë tematika që kanë të bëjnë me nënfushat kryesore të kërkimit shkencor në gjuhësi dhe studime historike mbi të cilat do të bazohen programet individuale të studiuesve. Kërkimi shkencor në fushë të shkencave albanologjike ka tashmë një traditë të gjatë dhe ka krijuar një fond të gjerë punimesh e veprash përgjithësuese për historinë e shqiptarëve, gjuhën dhe kulturën e tyre.

Interesi nga studiues vendas dhe të huaj për gjuhët e tjera që na rrrethojnë, është po aq i rëndësishëm sa edhe ai për gjuhën shqipe, strukturën, nënsistemet e saj, standardin dhe përdorimin e saj sot. Po ashtu ky projekt synon edhe integrimin e pakicave kulturore dhe gjuhësore të qytetit, duke shprehur interes për studimin e tyre, kryesisht të pakicës rome dhe asaj kulturore ballkano-egjiptiane. Hartimi i fjalorëve të toponomastikës së rajonit të Elbasanit, i fjalëve dhe shprehjeve për çdo rast, i pasurisë gjuhësore të romishtes në rajonin tonë, por edhe në zonat në kufi me Elbasanin, janë vetëm disa nga produktet e synuara me interes për të tretët, që do ta pasuronin në mënyrë të veçantë shkencën dhe komunitetin përtej rajonit.



Objektivat e projektit:

- Thellimi i studimeve në fushën e albanologjisë referuar traditës dhe përvojës që ka Fakulteti i Shkencave Humane në këtë fushë;
 - Organizimi i studimeve doktorale mbi bazën e hartimit të projekteve individuale;
 - Nxitja e aftësive kërkimore-shkencore dhe analitike të studiuesve të rinj për kërkim të pavarur shkencor;
 - Motivimi i studentëve drejt veprimtarive krijuar duke trajtuar tematika në fushën e gjuhës së lidhen me drejtshkrimin e gjuhës shqipe, normën morfologjike dhe atë sintaksore, onomastikën, me fokus të veçantë në toponomastikën e Qarkut të Elbasanit;
 - Përmirësimi i formimit shkencor të doktorantëve nëpërmjet punës kërkimore-shkencore, për të vlerësuar, analizuar dhe reflektuar ndaj burimeve të reja dokumentare të dala në drithë kohët e fundit dhe arritjeve të mëparshme në fushë të historiografisë shqiptare;
 - Vlerësimi i figurave dhe rolit të trevës së Elbasanit në fushën e arsimit lokal e kombëtar;
 - Zhvillimi i aftësive të studentëve doktorantë në publikimin e botimeve që do të realizohen në kuadrin e projektit doktoral, duke i dhënë opinionit shkencor vepër themelore për historinë, gjuhën, kulturën dhe traditat, si dëshmi e identitetit kombëtar të shqiptarëve.
- Në kushtet e sotme të zhvillimeve botërore, realizimi i këtyre studimeve ka rëndësi për ruajtjen e veçorive kombëtare si shprehje e diversitetit të kulturave e qytetërimeve.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT TË LARTË KU DO TË ZBATOHET PROJEKTI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 12.11.1991. Ai është institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor në Republikën e Shqipërisë, i ngritur në statusin universitar mbi Institutin e Lartë Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani” (ILP) të Elbasanit. ILP-ja, ky institucion i lartë arsimor që ka përgatitur mësues për shkollën 8-vjeçare dhe të mesme, u ngrit më 1971 dhe ka funksionuar deri më 1991. ILP-ja u themelua duke u mbështetur në traditën e përgatitjes së mësuesve në shkollën Normale të Elbasanit, si dhe në përvojën e grumbulluar në dy filialët pararendëse të tij, njëri i Universitetit të Tiranës dhe tjetri i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, si edhe të trashëgimisë së veprimtarisë së gjërë shkencore e arsimore të mjaft studiuesve e mësuesve elbasanas. UE është një nga universitetet më në zë të vendit për përgatitjen e mësuesve, të specialistëve dhe studiuesve të rinj në fusha të ndryshme të dijes. Sot, Universiteti i Elbasanit vazhdon traditën arsimore në fushën e mësuesisë, por edhe në fusha të reja e dinamike të dijes e kërkimit shkencor. Veprimtaria e universitetit bazohet në Nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UE-së, si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani” është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 49, datë 27/11/2020. Akreditimi është i vlefshëm deri më 26.11.2026.

Në mënyrë të detajuar në UE funksionojnë:



I. *Fakulteti i Shkencave Humane*, me programe studimi Bachelor, Master profesional, Master i shkencave dhe Doktoratë në fushat e kërkimit të tij: gjuhë shqipe dhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht), histori, gjeografi, gazetari, albanologji, programe profesionale 2-vjeçare në sekretar i specializuar, si edhe operator turistik në gjuhën gjermane.

II. *Fakulteti i Shkencave të Natyrës*, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: biologji, kimi, botanikë, zoologji, mbrojtje mjedis, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, gjeometri, fizikë teorike e eksperimentale, si edhe programe profesionale 2-vjeçare në teknik laboratori, teknik mjedis, mekatronikë, logistikë.

III. *Fakulteti i Shkencave të Edukimit*, me programe studimi Bachelor, Master profesional në fushat e kërkimit të tij: mësuesi për ciklin fillor (klasës I-IV të shkollës 9-vjeçare), edukatorë për arsimin parashkollar, psikologji, filozofji, sociologji, edukim fizik dhe artistik, si edhe program profesional 2-vjeçar në edukator për moshat 0-3 vjeç.

IV. *Fakulteti Ekonomik*, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: administrim, biznes, financë, kontabilitet, ekonomia dhe e drejta, shkenca juridike në biznes, shkenca juridike në sektorin publik, ekonomi turizëm, administrim biznes, inxhinieri dhe informatikë ekonomike.

V. *Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike*, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: infermieri, infermieri mami, teknik laboratori, imazheri, manaxhim infermieror, fizioterapi dhe logopedi.

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE (FSHH)

Që me hapjen e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 1971, katedra e gjuhë-letërsisë ishte pjesë e njësisë së arsimit të lartë. FSHH-ja është njësia me traditën më të gjatë në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Ky fakultet përmban programe studimi me ndikim shoqëror dhe është një faktor në tregun e punës dhe në kulturën jo vetëm të qytetit të Elbasanit, por dhe më gjërë. Aktualisht, Fakulteti i Shkencave Humane ka në përbërjen e tij departamentet e gjuhësisë, të letërsi dhe gazetarisë, histori-gjeografisë, gjuhëve angleze dhe gjermane, frëngje dhe italiane, dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike “Aleks Buda” (QSAB).

PËRSHKRIMI I BASHKIMIT TË NJËSIVE KU DO TË ZBATOHET PROJEKTI

Për realizimin e projektit “Albanologjia dhe realitetet e reja në metodologji dhe burime” është nënskruar marrëveshja e bashkëpunimit, me qëllim realizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë në albanologji”, që do të zbatohet nga njësitë bazë, si më poshtë:



NJËSIA BAZË

Departamenti i gjuhësisë
Departamenti i histori-gjeografisë
Qendra e Studimeve Albanologjike
dhe Ballkanologjike “Aleks Buda” (QSAB)

NJËSIA KRYESORE

FSHH
FSHH
FSHH

Që me hapjen e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 1971 e më pas, programet e studimit në FSHH kanë ardhur duke u shtuar. Fakulteti i Shkencave Humane ofron sot këto programe studimi:

Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi,
Bachelor në gjuhë frëngje,
Bachelor në gjuhë italiane,
Bachelor në gjuhë angleze,
Bachelor në gjuhë angleze,
Bachelor në histori-gjeografi,
Bachelor në gjuhë shqipe dhe frëngje,
Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome,
Program studimi me karakter profesional në operator turistik në gjuhë gjermane,
Program studimi me karakter profesional në sekretar të specializuar dhe administrativë,
Program studimi me karakter profesional në operator turistik,
Master profesional në redaktim,
Master profesional në gazetar reporter,
Master i shkencave në studime historike,
Master i shkencave në trashëgimi kulturore,
Masteri i shkencave në gjuhësi.

Fakulteti i Shkencave Humane, përmes bashkëpunimit me fakultete të tjera brenda dhe jashtë vendit, ka fituar një përvojë të rëndësishme në fushën e studimeve albanologjike, duke krijuar një trashëgimi akademike dhe traditë të gjatë në mësimdhënie në lidhje me përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e albanologjisë. Programi i doktoraturës në FSHH është hapur për herë të parë në vitin akademik 2011-2012 dhe aktualisht kanë përfunduar me sukses punimet e tyre doktorale 19 doktorantë nga vendi dhe trevat shqiptare me rezultate dhe vlerësime të larta. Gjithashtu, personeli akademik i këtij fakulteti, ndër vite ka qenë dhe vijon të jetë pjesë përbërëse e stafeve akademike të universiteteve vendase dhe të universiteteve ndërkombëtare, i përfshirë në mësimdhënie e kërkim shkencor, sikurse edhe personeli akademik nga universitete ndërkombëtare, ka qenë i atashuar ndër vite pranë departamenteve të FSHH-së. Fakulteti i Shkencave Humane përbëhet nga një staf akademik i kualifikuar në raportin 79% me tituj dhe grada shkencore, ku përmendim 3 profesorë, 15 profesorë të asociuar, 26 doktorë shkencash, pjesa tjetër janë në proces kualifikimi për marrjen e gradave shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Pjesë e FSHH-së është edhe



Qendra e Studimeve Albanologjike “Aleks Buda”, një qendër kualifikimi dhe kërkimi shkencor, e cila ofron gjithashtu këshillimin dhe materiale të pasura në shërbim të programit.

PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROJEKTIT

Projekti kërkimor “Albanologjia dhe realitetet e reja në metodologji dhe burime” do të zhvillohet në dy profilet e albanologjisë: gjuhësi dhe histori. Drejtimet kryesore do të realizohen nga dy departamentet e përfshira në ciklin e tretë të studimeve, departamenti i gjuhësisë, i histori-gjeografisë, si edhe qendra kërkimore-shkencore (QSAB). Në Takimin e Tretë Botëror të Akademikëve të Rinj (shtator 2017), ku u diskutua për rolin që shkencëtarët e rinj duhet të marrin për përbushjen e objektivave globale për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG), u theksua se: “*shkenca ka një rol thelbësor në këtë përpjekje dhe ky rol qendoror i saj duhet njojur dhe përdorur për të përbushur objektivat e qëndrueshme....*”. Kështu që shkenca nuk mundet dhe nuk duhet të karakterizohet nga zhvillimi i rastësishëm, nga forca individuale, por ajo duhet bërë pjesë e qëndrueshme e sistemit universitar, ku individi bëhet ose pjesë e prodhimit shkencor, ose e përsitimit të këtij prodhimi.

Dikur kërkimi shkencor ishte pjesë e instituteve kërkimore në nivel qendoror dhe studiuesi i ri ndiqte modelin e drejtuesit të vet shkencor; por sot, me masivizimin e tij, ai është bërë pjesë e natyrshme e kurrikulës universitare, veçanërisht në ciklin e tretë të studimeve, atë të doktoratës.

Mund të themi se kërkesa për cilësi e kërkimit shkencor kushtëzohet nga shumë faktorë (niveli shkencor i kërkuesit, përdorimi dhe shfrytëzimi i një literaturë të gjerë e bashkëkohore, përdorimi i teknologjive të reja, mbikëqyrja e kujdeshsme prej drejtuesit shkencor etj.), por ne besojmë se ndikimi më i rëndësishëm dhe pozitiv në rritjen dhe sigurimin e cilësisë lidhet drejtpërdrejt me metodologjinë e përditësuar të kërkimit shkencor, d.m.th. me rrugën, modelet, metodat, shembujt që duhen ndjekur për kryerjen e studimit shkencor. Gjithashtu, të rëndësishme janë në këtë pikëpamje edhe burimet e dokumenteve, të cilat në dritën e mundësive të reja për komunikim dhe shkëmbim kulturor po bëhen më të aksesueshme dhe të disponueshme.

Në këtë realitet, Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave Humane do të përpinqet të riorganizojet programin e ciklit të tretë në fushën e albanologjisë e, veçanërisht, në dy profilet shkencore: gjuhësi dhe studime historike.

Në këtë kuadër, lidhur me strategjitet e zhvillimit të departamenteve të Fakultetit të Shkencave Humane, që lidhen drejtpërdrejt me studimet në fushë të albanologjisë, ky cikël doktoral synon evidentimin, zbulimin dhe vlerësimin e traditës shkencore albanologjike me theks në qytetin e Elbasanit që i kalon kufijtë e lokales, vlerësimin e kontributeve mbarëkombëtare të personaliteteve albanologjike edhe të trevës së Elbasanit, përfshirjen e studiuesve të njësive të ndryshme shkencore e akademike në këtë projekt, dhe po aq përfshirjen e studentëve më të mirë që shfaqin interesa në kërkimin shkencor.

Pjesë e këtij projekti do të jetë zgjerimi i tematikave të kërkimit dhe të bashkëpunimit shkencor mes njësive të ndryshme kërkimore brenda FSHH-së, por edhe në nivel mbarëkombëtar: departamente, qendra e institute kërkimore, mes pedagogëve dhe studentëve në fushën e studimeve



për gjuhën shqipe dhe atyre historike, por duke përfshirë edhe fusha të tjera me të cilat albanologjia takohet: studime letrare, folklorike, etnologjike, historike, albanologjike, antropologjike etj. Realiteti shkencor i shek. XXI karakterizohet nga multidisiplinariteti, gërshetimi i metodologjive shkencore dhe vështrimi i objektit kërkimor në lidhje me faktorë të tjerë ndikues, duke u përpjekur të rroket shumanshmëria e tij dhe kështu bëhet e natyrshme të vështrohet albanologjia në dritën e metodave të reja që vijnë nga shkenca të tjera.

Hapja e albanologjisë ndaj shkollave, qasjeve të tjera e të reja të studimit të gjuhës e historisë, produktit letrar e kulturor në hapësirë e kohë, për trajtimin e çështjeve të përgjithshme e të veçanta, kërkon detyrimisht njohjen shkencore të veprës dhe të studiuesve që kanë hedhur baza të qëndrueshme për zhvillimet e mëtejshme të gjuhësisë, një reflektim tjetër në lidhje me realitetin dhe përpjekje për ta ndryshuar atë në dritën e të dhënave të tjera.

Prej disa vitesh, Universiteti i Elbasanit dhe, veçanërisht, Fakulteti i Shkencave Humane i është kushtuar albanologjisë përmes projekteve kërkimore të finalizuara me konferanca shkencore, botime të monografive shkencore të studiuesve të vet dhe, më tej, përmes realizimit të studimeve doktoriale cilësore, duke u mbështetur në vlerësimet e doktoratave prej jurisë së përbërë nga studiues të njohur të fushës. Gjatë dhjetë viteve të fundit janë realizuar:

- Dhjetor 2009, Konferenca me temë “Shkollë kombëtare, arsim kombëtar”, organizuar si projekt kërkimor nga Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike (QSAB) në UE.
- Dhjetor 2010, Konferencë Kombëtare me temë “Mahir Domi”, organizuar nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe Universiteti i Tiranës.
- Maj 2016, Konferencë ndërkombëtare me temë “Aleks Buda dhe studimet albanologjike”, organizuar nga QSAB-ja në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
- Nëntor 2017; Konferencë shkencore kombëtare “Korpusi letrar elbasanas në shek. XX”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Universitetin e Elbasani “Aleksandër Xhuvani”, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.
- Mars 2019, Konferencë shkencore ndërkombëtare “Punëtorë të shquar të albanologjisë”, organizuar në Universitetin e Elbasani “Aleksandër Xhuvani” në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike (ASA).
- Dhjetor 2019, Realizimi i Javës së Albanologjisë, me prezantimin e fondit të dhuruar nga albanologu frëng Christian Gutt, përkujtimin e veprës shkencore të studiuesve të Elbasanit, me kontributet mbarëkombëtare, si: Mehmet Çeliku, Astrit Bishqemi, Ali Shashaj.

Gjithashtu, në fokusin e studimeve albanologjike, ka pasur interes shkencor për të hulumtuar edhe pakicat etnike të rajonit të Elbasanit dhe përtej, duke u finalizuar me organizimin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Pakica ballkano-egiptiane dhe komunitetet etnokulturore në Shqipëri”, organizuar nga UE “Aleksandër Xhuvani”, Akademia e Studimeve Albanologjike, Universiteti Euro-Ballkan i Shkupit, më 22 qershor 2018, Elbasan.

Gjithashtu, profesorati i Fakultetit të Shkencave Humane është i përfshirë në studime, si pjesëmarrës në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, dhe hartues monografish shkencore që lidhen me studimin e figurave dhe të dukurive të rëndësishme të albanologjisë,



- Teuta Toska, "Elemente të mendësisë shqiptare në frazeologji", shtëpia botuese "Naimi", Tiranë, 2014, ISBN 978-9928-109-70-5.
- "Mësime të vyera a fjalë shpirtërisht të folura në mësonjëtoren shqipe të çupave në Korçë (1896)", transliteroi, pajisi me shënime (filologjike), hartoij fjalorin e termave fetarë (me disa shpjegime), pajisi me një hyrje studimore, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2017, ISBN 978-9928-104-69-4.
- "Parashqevi Qiriazi dhe viti i saj 1919", Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, Tiranë, 2020, ISBN 978-9928-451-97-2.
- Rudina Mita, me monografinë "Elbasani-Jeta politike në vitet 1920-1924", Shtëpia botuese "Ilar" 2007, ISBN 978-99956-07-02-9.
- Monografia "Pluralizmi politik shqiptar gjatë viteve 1914-1924", (R. Mita, H. Kordha), Shtëpia botuese "Rama Graf" 2011, ISBN 978-9928-115-04-1.
- Përbledhje dokumentesh "Aqif pashë Biçakçiu" (1844-1926), (M. Belegu, H. Kordha, R. Mita), Shtëpia botuese "Marin Barleti", ISBN 978-99956-10-50-0.
- Përbledhje dokumentesh "Elbasani në vitet 1925-1940", (R. Mita, R. Gjini). Shtëpia botuese "Maluka", Tiranë 2015, ISBN 978-9928-134-63-9.
- botuese "Morava" 2014, ISBN 9789928169389.
- Roland Gjini me "Histori e Romës së lashtë", Botues "Albas" 2015, ISBN: 978-9928-02-500-5."Histori e qytetërimeve antike", tekst universitar, Tiranë, SHBLU 2006, ISBN999270385.
- Albert Riska me "Arumunët-shënime për gjuhën dhe kulturën", Sejko, Elbasan, 2004.
- "Trajtesa gjuhësore", Pegi, Tiranë, 2011.
- "Via Egnatia - nga Durrësi në Ohër, AthenaVerlag, Oberhausen (me bashkautorë).
- "Shqipja dhe krishterimi", Dituria, Tiranë, 2012.
- "Gjurmë të apofonisë indoevropiane në gjuhën shqipe", Kristalina KH, Tiranë, 2022.

Projekti kërkimor *do t'i japë* Elbasanit dhe trashëgimisë së tij albanologjike një dritë të re, studimin, promovimin dhe evidentimin e vlerave shkencore, qytetare dhe evropiane, përpjekjen për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkomunitare, integrimin e komuniteteve dhe depërtimin në njojjen e të vërtetave shkencore.

Projekti do të gërshtojë mësimdhënien me kërkimin shkencor, do të angazhojë forcat më të rëndësishme akademike të Universitetit të Elbasanit dhe studentët më të mirë, të cilët shprehin dëshirën për përparim në karrierën akademike.

Kërkimi shkencor në fushën e gjuhësë, veçanërisht ai që lidhet me pakicat gjuhësore në rajonin e Elbasanit dhe veçorive gjuhësore të trevës, paraqet interes për projekte të përbashkëta me interes për institucionë të ndryshme publike e private, por edhe për universitete përtej Shqipërisë, duke sjellë kështu aplikimin dhe përfshirjen e doktorantëve dhe udhëheqësve shkencorë në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, duke synuar edhe një ndikim në politikat e qeverisjes rajonale, në lidhje me çështje kulturore, të komunikimit, të trajtimit të trashëgimisë kulturore dhe të integrimit të pakicave etnike.

Nisur nga kjo panoramë e kontekst, drejtimet kryesore të kërkimit në fushë të gjuhësë do të janë:



- Përdorimi i standardit (drejtshkrimi dhe pikësimi i shqipes) në sistemin parauniversitar (nxënës, mësues, drejtues etj.), matje statistikore, vlerësim cilësor i të dhënave, rekomandime për përmirësimë në mësimdhënie, në kualifikim, në trajnime etj;
- Çështje të onomastikës dhe veçanërisht të toponomastikës në rajonin e Elbasanit edhe më gjerë;
- Shqipja dhe shënimi i kohës, hapësirës, emocioneve parësore dhe dytësore.

Cikli i tretë i studimeve “Doktoratë në albanologji” në FSHH mbështetet në fushën e studimeve të gjuhësise dhe historisë përmes projekteve kërkimore shkencore me tematika të larmishme.

Projekti me temë *Tradita arsimore e Elbasanit nga mesi i Shek. XIX deri në vitet '20-'30 të shek. XX*, synon evidentimin, zbulimin dhe vlerësimin e traditës arsimore të qytetit të Elbasanit, që i kalon kufijtë e lokales, vlerësimin e kontributave kombëtare e mbarëkombëtare të personaliteteve të trevës së Elbasanit në fushën e arsimit, të kulturës, gjuhës e didaktikës shqipe, përfshirjen e studiuesve të njësive të ndryshme shkencore e akademikë vendas dhe të huaj në këtë konferencë, si dhe përfshirjen e studentëve me interesa në kërkimin shkencor.

Projekti *Elbasani në dokumentet arkivore 1945-1955*, synon që përmes burimeve arkivore të pashfrytëzuara më parë, të pasqyrojë gjendjen e arsimit në 10 vitet e para pas çlirimt të vendit, si dhe përpjekjet për të kufizuar analafabetizmin në trevën e Elbasanit dhe më gjerë.

Fokusi i projektit *Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore*, konsiston në pasqyrimin e zhvillimeve politiko – ushtarake në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore, krijimin e zonave ushtarake të pushtimit dhe administrimin e tyre përgjatë viteve të kësaj ngjarje tragjike. Pavarësisht se me fillimin e konfliktit botëror shteti i pavarur shqiptar shpalli asnjanësinë, Shqipëria u pushtua dhe shqiptarët luftuan në mbështetje të ushtrive të dy bloqeve ushtarake, si dhe në çfarë forme u përfshinë shqiptarët në këtë konflikt; ndarja e Shqipërisë në zona pushtimi, administrimi i Shqipërisë së Mesme gjatë kësaj lufte; viktimat e Luftës së Parë Botërore në Shqipëri që nuk janë dokumentuar, përbëjnë çështje që duhen trajtuar në dritën e burimeve arkivore vendase dhe të huaja. Gjithashtu, në fokusin e këtij projekti janë edhe tematika të rëndësishme që lidhen me: arsimin në trevën e Elbasanit në vitet '40 - '90 të shek. XX, trashëgiminë kulturore në trevën e Elbasanit, Reformën Agrare në Elbasan (1945-1960), pozitën e gruas shqiptare përgjatë shek. XX, kontributin e figurave dhe personalitetë të fushave të ndryshme në trevën e Elbasanit dhe më gjerë.

METODOLOGJIA E PROJEKTIT

Metodologjia e projektit ka të bëjë me profilizimin e profesionistëve në fushat e kërkimit në shkencën e albanologjisë. Kandidatët paraqesin projekt-propozimet e tyre brenda kuadrit të Albanologjisë në përputhje me fushën e përgjithshme të kërkimit, fushat specifike të kërkimit si dhe me profilin e programit të studimit. Projektet kërkimore shkencore do të janë të bazuara në studime cilësore dhe sasiore në fushën e albanologjisë. Objektivi i kërkimit shkencor konsiston në një profil studimi gjithëpërfshirës, ndërdisiplinor, në të cilin doktorantët kanë mundësinë të fitojnë njojuri të thelluara me lidhje të drejtpërdrejtë kërkimore rrëth veçorive gjuhësore, historike dhe kulturore që karakterizojnë rajonin shqipfolës në Ballkanin Perëndimor. Baza është njojja e



thelluar e shqipes në varietetet e saj të larmishme, të lidhura me peizazhin e kulturës së shkruar shqiptare. Njëkohësisht, theks i kushtohet çështjeve të shqipes standarde.

Në lidhje me rëndësinë e fushave të kërkimit, programi i këtij cikli studimi synon të evidentojë rëndësinë që paraqesin kërkimet shkencore në temat specifike të parashtuara sipas fushave në përputhje me realizimin e objektivave kombëtare dhe lokale.

Ky projekt synon të trajtojë tematika që kanë të bëjnë me nënfishat kryesore të kërkimit shkencor në gjuhësi dhe studime historike mbi të cilin do të bazohen programet individuale të studiuesve. Nënfishat apo drejtimet kryesore të kërkimit në fushë të gjuhësë dhe historisë përfshijnë:

- Përdorimi i standardit (drejtshkrimi dhe pikësimi i shqipes) në sistemin parauniversitar (nxënës, mësues, drejtues etj.), matje statistikore, vlerësim cilësor i të dhënave, rekomandime për përmirësimë në mësimdhënie, në kualifikim, në trajnime etj;
- Çështje të onomastikës dhe veçanërisht të toponomastikës në rajonin e Elbasanit dhe më gjerë;
- Shqipja dhe shënimi i kohës, hapësirës, emocioneve parësore dhe dytësore;
- Tradita arsimore e Elbasanit nga mesi i shek. XIX deri në vitet '20-'30 të shek. XX;
- Aspekte të trashëgimisë kulturore në trevën e Elbasanit;
- Reforma Agrare në Elbasan (1945-1960);
- Aspekte të historisë lokale të trevës së Elbasanit;
- Elbasani në fokusin e zhvillimit të marrëdhënieve shqiptaro-kineze;
- Ngjarje epokale në historinë bashkëkohore shqiptare.

Gjatë studimeve doktorale, studentët do të kenë mundësinë e trajnimeve mbi metodologjinë e kërkimit shkencor, për përmirësimin e formimit shkencor nëpërmjet punës kërkimore shkencore, për të vlerësuar, analizuar dhe reflektuar ndaj burimeve të reja dokumentare të dala në drithë kohët e fundit dhe të arritjeve të mëparshme në këtë fushë të historiografisë shqiptare. Në fokus qëndron edhe zhvillimi i aftësive të studentëve doktorantë në publikimin e botimeve që do të realizohen në kuadrin e projektit doktoral, duke i dhënë opinionit shkencor vepra themelore për historinë, gjuhën, kulturën dhe traditat, si dëshmi e identitetit kombëtar të shqiptarëve. Në kushtet e sotme të zhvillimeve botërore, realizimi i këtyre studimeve ka rëndësi për ruajtjen e veçorive kombëtare si shprehje e diversitetit të kulturave e qytetërimeve.

ORGANIZIMI I STUDIMEVE DOKTORALE

Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara planifikohet sipas kalendarit akademik, por në çdo rast, jo më pak se 3 vite dhe jo më shumë se 5 vite, duke u mbështetur dhe nga planifikimi doktoral i miratuar nga njësitë bazë: departamenti i gjuhësë, departamenti i histori-gjeografisë dhe QSAB-ja.



Plani i zhvillimit të studimit doktoral

Elementët e planit vjetor (3 vite)						
1	Formimi teorik	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Shqyrtimi i literaturës specifike të fushës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku përfshihen qëllimi, metodat, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme		
2	Përmirësim i planit të kërkimit shkencor	Analiza e të dhënave	Shqyrtimi i literaturës	Publikime shkencore për gjeljet në literaturë	Pjesëmarrje në konferenca	
3	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca, seminare)	Prezantim i punimit në departament	Përfundimi i disertacionit dhe i detyrimeve të tjera	Dorëzimi i disertacionit	Mbrojtja e disertacionit

Elementët e planit vjetor (5 vite)					
1	Formimi teorik	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Shqyrtimi i literaturës specifike të fushës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku përfshihen qëllimi, metodat, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme	
2	Aktivizimi në mësimdhënie	Përmirësimi i planit të kërkimit shkencor	Analiza e të dhënave		
3	Shqyrtimi i literaturës	Publikime shkencore përgjeljet në literaturë	Pjesëmarrje në konferenca		
4	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca, seminare)			
5	Prezantim i punimit në departament	Përfundimi i disertacionit dhe i detyrimeve të tjera	Dorëzimi i disertacionit	Mbrojtja e disertacionit	e



PLANIFIKIMI I ECURISË SË STUDIMIT TË DOKTORATËS

Planifikimi i ecurisë së studimit të doktoratës në programin “Doktoratë në albanologji”, bazuar në projektin kërkimor- shkencor të njësive bazë të FSHH-së, realizohet ndërmjet studentit doktorant që, së bashku me udhëheqësin shkencor, hartojnë një platformë studimi e cila përfshin:

- Strukturën e tezës së doktoratës të ndarë në vite;
- Literaturën që do të studiohet në kuadër të studimit;
- Platformën shkencore të studimit doktoral.

Struktura e platformës së studimit doktoral përban:

- Formulimin e problemit që do të studiohet;
- Analizën e bazës teorike që ka lidhje me problemin që do të studiojë studenti doktorant;
- Analizën e studimeve të kryera në lidhje me problemin që do të studiojë studenti doktorant;
- Pyetjet të cilave studimi do t'u japë përgjigje;
- Nëse ka, cilat janë hipotezat e studimit;
- Një pëershkrim i shkurtër i rëndësisë së studimit për fushën përkatëse;
- Metodologjinë e kërkimit (e përfshirë);
- Në dosjen e doktoratës dhe në platformën e studimit të përfshihet përvijimi i kërkimit, përfshirë edhe strukturën e përgjithshme të studimit.

Punimet dhe botimet që do të realizohen në kuadrin e këtij programi studimi, do t'i shërbejnë zhvillimit të mëtejshëm të shkencave humane dhe albanologjike duke i dhënë opinionit shkencor të brendshëm dhe të jashtëm vepra themelore për historinë, gjuhën, kulturën dhe traditat, si dhe problemet aktuale sociale të popullit shqiptar, të cilat, veç të tjerave, do të ndihmojnë për afirmimin e vlerave dhe të trashëgimisë së tij historike si dëshmi e identitetit kombëtar të shqiptarëve si popul. Në kushtet e sotme të zhvillimeve botërore, realizimi i këtyre studimeve ka rëndësi për ruajtjen e veçorive kombëtare si shprehje e diversitetit të kulturave e qytetërimeve.

Këto studime do të shënojnë një arritje të re shkencore në fushat përkatëse, do të përgjithësojnë rezultatet e arritura deri sot në këto fusha dhe hapin rrugë për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve humane dhe albanologjike. Ato do të venë në qarkullim shkencor përfundime e zgjidhje të reja, informacion të ri dhe teza që pasurojnë në nivel bashkëkohor mendimin në shkencat humane dhe albanologjike, përmes zbatimit të metodave e koncepteve moderne të studimit të dukurive historiko-shoqërore e kulturore të shoqërisë shqiptare. Por veprat e përgatitura në kuadrin e këtij programi do të gjejnë edhe një përdorim praktik, do të shërbejnë si mbështetje e domosdoshme për rishikimin dhe përditësimin e teksteve shkollore të fushave përkatëse, për hartimin e veprave me karakter divulgativ.

ANALIZA SWOT

Tabela 1: Pikat e fortë

Nr.	STRENGTHS (PIKAT E FORTA)
1	Reputacioni pozitiv në rajon në fushën e albanologjisë.



2	Fusha e albanologjisë është një traditë e vyer në arsimin shqiptar.
3	Trashëgimi akademike dhe traditë e gjatë në mësimdhënie në lidhje me përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e albanologjisë.
4	Infrastrukturë mësimore moderne.
5	Potencial i lartë intelektual i stafit akademik. Cilësia e stafit akademik, formimi dhe përvuja akademike brenda dhe jashtë vendit, niveli i kualifikimit në rritje, vërtetuar me gradat e titujt e fituar, garantojnë transmetimin efektiv të dijeve.
6	Rezultate të larta dhe të njohura të doktoruarve në këtë fakultet, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Programi i doktoraturës në këtë fakultet është hapur në vitin akademik 2011-2012 dhe kanë përfunduar me sukses punimet e tyre doktorale 19 doktorantë nga vendi dhe trevat.
7	Kërkesa gjithmonë e në rritje për këtë program studimi.
9	Numër i lartë i personelit akademik me titull duke mundësuar një numër të konsiderueshëm kuotash pranimi në këtë program.
10	Përthithje e nivelit më të mirë të konkurrentëve si studentë në UNIEL nga Shqipëria dhe trevat shqipfolëse, sipas kritereve konkurruese.
11	Metoda mësimdhënieje bashkëkohore bazuar në standarde evropiane të arsimit të lartë.
12	FSHH ka kapacitete infrastrukturore në lidhje me mjediset dhe laboratorët e vënë e dispozicion për realizimin e projekteve shkencore. Mjedise moderne dhe pajisje didaktike të standardeve ndërkombëtare.
13	E inkadruar në FSHH është edhe Qendra e Studimeve Albanologjike, qendër e kualifikimit dhe kërkimit shkencor, e cila ofron gjithashtu këshillimin dhe materiale të pasura në shërbim të programit.
14	Shërbim cilësor në mësimdhënie nga stafi akademik i motivuar.
15	Shërbime cilësore nga stafi ndihmës dhe mbështetës.
16	Bibliotekë dhe sala studimi me hapësira të bollshme studimi dhe literaturë bashkëkohore.
17	Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të cilat ofrojnë mbështetje për studimet shkencore në kuadër të projektit. (Biblioteka e qytetit, arkivat etj....)
18	Respektimi i vlerave reciproke staf akademik - student doktorant dhe etikës në komunikim.

Në tabelën (2) paraqiten **Weaknesses (pikat e dobëta)** të Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”:

Tabela 2: Anët e dobëta

Nr	WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)
1	Lidhje jo shumë të forta më institucionet në rajonin tonë dhe më gjerë, nëpërmjet të cilave studentët doktorantë të lidhin teorinë me praktikën.



2	Mungesë financiare: <ul style="list-style-type: none"> - Në mbështetjen e një infrastrukturre fizike dhe laboratorike edhe më të zhvilluar, - Kategorizimin dhe kualifikimin e personelit akademik, - Në mbështetjen e realizimit të projekteve shkencore, - Në kualifikimin e vazhdueshëm të stafit administrativ, që duhet të ketë vijimësi, pasi metoda e punës evoluojnë dhe formimi i kapitalit njerëzor luan një rol të rëndësishëm me qëllim që burimet ekzistuese të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme.
3	Mungesa e informacionit nga institucionet qendrore dhe lokale mbi kërkesat e tregut për këtë program studimi.
4	Rënia ndër vite e numrit të studentëve në degët e quajtura të mësuesisë, të cilët në të vërtetë janë ato që sjellin prurje (studentë) në programet e ciklit të tretë të doktoratës në albanologji.

Në tabelën (3) të mëposhtme paraqiten **Opportunities (Mundësitë)** e Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”:

Tabela 3: Mundësitë

Nr.	OPPORTUNITIES (MUNDËSITË)
1	Përfshirje në projekte dhe programe të ndryshme ne nivel evropian. Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në studime dhe kërkim shkencor; pasurimi i përvojës ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes në shkëmbime universitare me programet Erasmus+, Horizont 2020 etj.
2	Përfshirje në projekte të ndryshme të MASR-së që lidhen me problematikën e zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri.
3	Zhvillimi i konferencave dhe debateve shkencore ku nismëtar është Fakulteti i Shkencave Humane.
4	Botime të shumta shkencore në organin periodik të Universitetit të Elbasanit (Buletini Shkencor).
5	Integrimi dhe përsosja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare dhe institucionet e tjera të fushës së albanologjisë.

Në tabelën (4) të mëposhtme paraqiten **Threats (Kërcënimet)** për Fakultetin e Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”:

Tabela 4: Kërcënimet

Nr.	THREATS (KËRCËNIMET)
1	Konkurenca ndërmjet IAL-ve publike dhe private, programet e ngjashme të studimit të ofruara nga IAL publike apo private brenda vendit, mund të jenë një alternativë për studentët e nivelit të tretë të studimeve.



2	Tarifat e shkollimit do të merren përsipër nga vetë doktoranti sipas përcaktimeve në vendimet përkatëse të Bordit Administrativ të Universitetit të Elbasanit.
----------	--

ANALIZA E TREGUT TË PUNËS

Tregu i punës në fushën e albanologjisë ofron mundësi punësimi si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat. Në sektorin publik, nevoja për të doktoruar në “Albanologji” është e lartë.

Studimet në albanologji, përveç dhënies së njohurive bazë të kulturës, historisë dhe fesë në hapësirën shqipfolëse në Ballkan dhe më gjerë, mbulojnë gjithashtu zhvillimet aktuale në Shqipëri, Kosovë, Itali dhe Evropën Juglindore, sidomos në lidhje me njohuritë solide gjuhësore. Studimet në albanologji ofrojnë mundësi të shkëlqyera për një karrierë në disa fusha profesionale, si në institucione kulturore, arsimore, ministri, në muze, në shërbimin diplomatik, në biblioteka dhe në sektorin social ndërkulturor si menaxher projekti ose si ekspert i Shqipërisë në shtyp, ose në një institucion të lidhur me biznesin në rrjedhën e zgjerimit të BE-së drejt Lindjes.

Në tabelën e mëposhtme jepet numri i të punësuarve në institucionet publike gjatë vitit 2018, ku shikohet që numri i të punësuarve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Kulturës, si dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme është më i lartë, krahasuar me atë të ministrive të tjera.

Viti	2018
Kryeministria	150
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2.004
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	974
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5.818
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	31.004
Ministria e Kulturës	1.010
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	4.289
Ministria e Drejtësisë	5.688
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	551
Ministria e Brendshme	14.156
Ministria e Mbrojtjes	8.973
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1.037
Totali	75.654

Burimi: Ministria e Financave, Ligji Nr. 130/2016, Ligji Nr. 109/2017

Komente dhe analiza: Open Data Albania

Ndërkohe, në vitin 2018 me krijimin e institucioneve të reja kemi dhe krijimin e vendeve të reja të punës për profesionistët në fushën e albanologjisë. (Komente dhe analiza: Open Data Albania)

Në sektorin privat, të diplomuarit kanë mundësi të integrohen në sistemin e profesioneve të lira.



Përveç mundësisë së ushtrimit të profesioneve të lidhura ngushtësisht me profilin dhe formimin albanologjik të tyre, edhe sektori i subjekteve private është një mundësi më shumë për të punësuar të gjithë ato albanologë që duan të fokusohen në këtë drejtim në eksperiencën e tyre në punësim. Sipas INSTAT, kemi një numër të madh studentësh apo kërkesash për të studiuar në degët që lidhen me studimet albanologjike, kjo duke filluar nga viti akademik 2014-2015 e deri më 2018-2019.


Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit

Viti shkollor/akademik	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18	2018-19
Fushat e studimit					
Shkenca arsimi	13.654	11.236	11.779	10.689	10.062
Arte dhe shkenca humane	17.588	17.095	17.278	15.441	14.348
Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	10.462	13.073	10.004	12.259	14.086
Biznes, administrim dhe ligj	42.089	41.523	36.471	30.233	33.447
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	10.473	6.719	7.816	6.325	7.060
Teknologji e informacionit dhe komunikimit	9.560	8.260	7.487	8.228	10.016
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	18.728	18.005	18.480	18.730	20.019
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	10.171	8.383	7.086	4.564	4.999
Shëndet dhe mirëqenie	22.780	21.550	20.900	19.837	20.727
Shërbime	5.022	2.433	2.306	3.088	4.279
Fushë e panjohur	2.017	0	0	0	0
Gjithsej*	162.544	148.277	141.410	131.833	139.043

Sipas Manualit të Fushave të Studimit ISC, F-2013. *Të dhënat e Isced 4 janë riklasifikuar në nivelin Isced 5.

Burimi i informacionit: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë

Fleksibiliteti i kurrikulës, mundësia e marrjes së një specializimi janë hapa të sigurt që çojnë drejt një tregu pune më një profil akademik të mirëpërcaktuar.



GRUPI I PUNËS PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik	Instituci oni	Njësia bazë/kryesore	Lloji i angazhimit (me kohë të plotë)
1	Abdulla Ballhysa	Prof. dr.	UE	Departamenti i Gjuhësisë	Personel akademik
2	Roland Gjini	Prof. dr.	UE	QSAB “Aleks Buda”	Personel akademik
3	Albert Riska	Prof.asoc.dr.	UE	Departamenti i Gjuhësisë	Personel akademik
4	Teuta Toska	Prof.asoc.dr.	UE	Departamenti i Gjuhësisë	Personel akademik
5	Meleq Shopi	Prof.asoc.dr.	UE	Departamenti i Gjuhësisë	Personel akademik
6	Rakela Luniku	Prof.asoc.dr.	UE	Departamenti i Gjuhësisë	Personel akademik
7	Rudina Mita	Prof.asoc.dr.	UE	Departamenti i Historisë	Personel akademik

FINANCIMI I PROJEKTIT

Shpenzimet për realizimin e projektit do të financohen nga tarifat e studimit të doktorantëve, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit të UE-së, por dhe nga projekte të ndryshme ku institucioni merr pjesë, si edhe financime nga institucione të tjera financiare publike dhe private

- *Numri maksimal i studentëve që do të pranohen në këtë program:*

7 (shtatë)

Bazuar në koeficentët e rekomanduar nga MASR për mënyrën e llogaritjes së pagës mesatare të stafit akademik me tituj shkencorë dhe pagës së personelit ndihmës akademik, është llogaritur kostoja e përgjithshme e studimeve për një doktorant, e cila parashikohet në vlerën 1,343,473 lekë.

Nr	Shpenzime	Lek
1	Shpenzime për pagat e sigurime shoqërore	365,026
-	Paga/ Prof. prof. Asoc.	299,953
-	Paga pers/ndihmës	12,838
	Sigurime shoqërore	52,236



2	Shpenzime të tjera	101,984
	Për shërbime	32,995
	Për investime	68,989
	Shuma e shpenzimeve	467,010

Universitet publike financohen kryesisht me bashkëfinancim: Grant nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e universitetit. Tarifa e studimit është parashikuar të përballohet 80% nga të ardhurat e krijuara nga pagesa e tarifës dhe 20% nga Granti i Buxhetit të Shtetit, duke llogaritur kuotën prej 7 studentë me tarifën e parashikuar 150 000 lekë në vit.

Koordinatore

Dr. Aurela Bashapçi

